



MEMORANDUM INFORMIMI

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.74
PEJ172/101 – NPB Malishgani, Klinë

Njësia e Vendosur në Tender	Njësia nr. 57 – Parcela nr. 220 dhe 222-0 në ZK Dush i Vogël, Klinë					
Vendndodhja e Aseteve ¹	Shikoni këtë pronë në Google Maps 1 Shikoni këtë pronë në Google Maps 2					
Zona Kadastrale / Komuna	Dush i vogël/ Klinë					
Kategoria e potencialit të pronës përfshirë	Rezidenciale					
Çmimi minimal për €/ari/Objekte	1,350 €/ari	Sipërfaqja e pronës në m ²	5946 m ²			
Depozita e Ofertës	8,000 €	Dita e Ofertimit	23/07/2025 Ora: 10:00h - 12:00h			
Procesi i Ofertimit dhe Rregullat e Tenderit	Kriteret dhe procesi përgatitjen dhe parashtrimin e ofertës janë përcaktuar në Rregullat e Tenderit					
Përshkrimi i Aseteve (Ndërtesa dhe tokat)						
<p>Kjo njësi përfshinë parcelën nr.220 me sipërfaqe 41ari60 m² (4160m²) me kulturë arë e klasës 6 dhe parcelën nr.222-0 me sipërfaqe 17ari 86m² (1786m²) me kulturë arë e klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme 59ari 46m² (5946m²) që ndodhen në ZK Dush, Komuna Klinë.</p> <ul style="list-style-type: none">-Parcelat kadastrale me nr. të njësisë 220 dhe 222 shtrihen në jug të zonës kadastrale Dush;-Gjendja kadastrale e tokës përputhet me gjendjen kadastrale juridike;- Parcata kadastrale me nr. të njësisë 220 nuk ka qasje në rrugë publike;-Parcata kadastrale me nr. të njësisë 222 ka qasje në rrugë publike;-Brenda parcelës 220-0 ndodhet shtylla elektrike (nga druri);- Parcelat janë të punuar.						
Shfrytëzuesit	Parcata nuk janë dhënë në shfrytëzim nga AKP dhe se shfrytëzohen nga persona të panjohur të cilën e punojnë pa lejen e AKP/AL-së.					
Asetet tjera	Nuk ka.					
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.					

¹ Të dhënat e hartës ©2024 Google

Akt-mohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të aseteve të përshtkuara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarrur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.



Dokumentet pronësore

Ndërmarrja dhe AKP-ja posedon Certifikatën Pronësore dhe Kopjen e Planit për këtë aset. Dokumentet me detajet tjera relevante gjenden në Dosjen Elektronike të krijuar për asetin në shitje (DE)

Sipas certifikatës së pronësisë me nr. lëndës 11-1271-2025 e lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Klinë (16.05.2025) prona evidentohet në emër të "NPB Malishgan", Klinë. Detajet ndodhen në DE.

Foto/fotot Ose informata të tjera Për asetet në shitje




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Legjenda:

- Parcelat kadastrale, KBI Malishgan
Ortofoto e vitit 2018
Zona kadastrale Dush, Komuna Klinë

Nr	Parcela kadastrale	Sipërfaqja m ²	Kultura	Klasa
1	220-0	4160	Arë	6
2	222-0	1786	Arë	5
Sipërfaqja e përgjithshme:			5946	



0 10 20 30 40 50
Meters

Shënim i rëndësishëm:

Blerësi i ardhshëm do të merr mbi vete përgjegjësinë për regjistrimin e pronës (p.sh.tokë/objekt), në regjistrat përkatës publik, dhe për rreziqet dhe pengesat që mund të paraqiten në procedurën e regjistrimit si dhe të siguroj qasjen në objekt. AKP-ja nuk merr kurrrafarë përgjegjësie lidhur me këto çështje.

Prona është e regjistruar në emër të paraardhësit të NSH-së. Sipas Urdhèresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2005/12 për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës së Shfrytëzimit të Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, neni 3, në mes tjerash ceket se "dhënia me qira themelohet në pajtim me dispozitat e Rregullores për përdorimin e tokës edhe nëse e drejta e shfrytëzimit të pasurisë së përmendur është regjistruar në emër të paraardhësit ligjor të Ndërmarrjes Shoqërore apo në emër të çfarëdo subjekti...".

Kushtet e përgjithshme

Të gjitha asetet e përfshira këtu janë ofruar për shitje në bazë të "sëç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në pajtim me termat dhe kushtet ligjore të shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar këto terma, AKP-ja nuk jep asnjë



garanci të shprehur apo të nënkuptuar për sa i përket kushteve të asetit (eve) të shitur-a, ose përshtatshmërisë së tyre për çfarëdo përdorimi ose qëllimi. Verifikimi i përshkrimit dhe kushteve i të gjitha aseteve është përgjegjësi e ofertuesit.

Qasja në asete dhe të dhënat përkatëse për hetim kërkojnë autorizim paraprak nga AKP-ja.

AKP-ja, me takim të paracaktuar, do të lejojë blerësit potencialë të inspektojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentet që janë në dispozicion në lidhje me asetet, në Zyrën Qendrore të AKP-së në Prishtinë.

Heqje dorë nga përgjegjësia

Informatat që janë dhënë në Memorandumin për Informim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike, për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk merr përgjegjësi, pa marr parasysh natyrën e tyre. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk garanton ose nuk merr përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë e ndonjë ankesë, deklarate ose informate në këtë Memorandum për Informim. Agjencia Kosovare e Privatizimit në asnjë rrethanë nuk është përgjegjëse për çfarëdo dëmi, qoftë i drejtpërdrejtë, tërthortë, i veçantë, i rastësishëm, me pasoja, ose dëme të tjera përfshirë por jo vetëm, humbjen e fitimit, pavarësisht nëse Agjencia Kosovare e Privatizimit është këshilluar për mundësinë e dëmeve të tillë që rrjedhin nga pasaktësitet (ose mos përfshirja e informacionit) në këtë dokument ose nga përdorimi ose paaftësia për të përdorur këto informata. Këto Informata nuk ju kufizojnë për këshillimin profesional të pavarur ose inspektimet apo kërkimet e pavarura para marrjes së vendimit për blerjen e aseteve.

Inkurajohen ofertuesit potencial të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak në këtë çështje dhe do të konsiderohen se janë në dijeni për të gjitha të dhënat publike që i përkasin hipotekës/pengut. Blerësi potencial është plotësish përgjegjës që vetë të bëjë hulumtimin e tij paraprak të gjendjes. As AKP dhe Autoriteti i Likuidimit nuk marrin përgjegjësi për ndonjë ngarkesë ose peng në pronë.

“Shënim: Deri më tanë në lidhje me kërkimet e kreditorëve, të pronësise dhe atyre për rikthim vlejnë dispozitat e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme te Gjykatës Supreme të Kosovës që konstatojnë të drejtën, titullin apo interesin për ndonjë pasuri në posedim apo kontroll të ndonjë ndërmarrje të privatizuar nga AKP-ja. Nëse Dhoma e Posaçme më vonë përcakton se pretenduesi ka qenë një pronar legitim për ndonjë pasuri apo interes që ndërlidhet me ndonjë pjesë të pasurisë, atëherë në përputhje me nenin 10 parografi 3 të po këtij ligji, parashtruesi i kërkimesës do të jetë i kualifikuar vetëm për kompensim monetar. AKP nuk garanton që juridikioni i Dhomës se Posaçme do të ketë një interpretim tjetër në lidhje me nenin 10 dhe nuk do e njeh interesin e kërkuesit për atë aset”.

AKP-ja interpreton nenin 10.3 duke e definuar që çdo kërkësë për kompensime monetare duhet të jetë kundër ndërmarrjes e cila ka shitur pjesë apo në tërësi pasurinë dhe jo kundër AKP-së apo blerësit të ri të kësaj pasurie. Duke marr parasysh rregulloret e pa testuara ligjore, nuk mund te sigurohet se Dhoma e Posaçme ose gjykatat tjetra do të pajtohen me këtë interpretim, andaj blerësi i ri duhet të jetë i vëmendshëm me rreziqet e mundshme.

Ofertuesi potencial këshillohet të hulumtoj dhe të verifikoj numrin, madhësinë dhe shtrirjen e Rrugëve po ashtu të pajtohet dhe të marr përsipër të mos i mbyllë dhe as të pengojë Rrugët, por t'i lërë ato të hapura dhe të kalueshme për palët e treta, përvëç nëse autoritetet përkatëse japid autorizim apo leje të duhur për t'i mbyllur rrugët.

Gjithashtu ofertuesit potencial inkurajohen të kryejnë hulumtimin nëse ngastrat e ofruara per shitje janë të përfshira në planin urban të komunës. AKP nuk merr përgjegjësi nëse në të ardhmen blerësit i shfaqet ndonjë pengesë që lidhet me potencialin e shfrytëzimit të pronës.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk mban përgjegjësi për mospërputhjet ndërmjet të dhënavë tekstuale (në Certifikatën e Pronësise) dhe të dhënavë grafike (plane kadastrale, ortofoto, skica) apo gjendjes faktike në terren lidhur me pasurinë që ofrohet për shitje.

Shitia bëhet në gjendjen ekzistuese (“as-is”), dhe çmimi bazohet vetëm në sipërfaqen dhe përshkrimin në Certifikatën e Pronësise.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Blerësi është përgjegjës për të kryer verifikimet e nevojshme teknike dhe ligjore para blerjes, dhe nuk mund të kërkojë kompensim apo anulim të kontratës për shkak të këtyre mospërputhjeve, as para e as pas shitjes. Duke dorëzuar ofertën e vet dhe/ose duke nënshkruar Kontratën e Shitjes, Blerësi pranon pa rezerva këtë Aktmohim, kushtet e tij dhe pasojat ligjore që rrjedhin prej tyre.

Për më tepër, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk bën asnjë deklaratë për ndonjë informatë tjeter që mund të qaset përmes përdorimit të këtij Memorandum Informimi. Informatat e përfshira në këtë Memorandum për Informim nuk mund të ndryshohen ose riprodhohen në mënyrë elektronike apo formë tjeter, pa lejen paraprake me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka të drejtë të bëj ndryshime dhe azhurnime në këtë Memorandum për Informim.

Pyetje dhe Kërkesa:	Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik Agjencia Kosovare e Privatizimit Tel: +383 (0) 38 500 400 lok. 1090, 2059 e-mail: marketing@pak-ks.org
----------------------------	---